



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 64/4 prot.

Tiranë, më 19.02.2024

REKOMANDIM

Nr. 01, datë 19.02.2024

PËR KONTROLLUESIN “QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT”

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), si dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “Qendra Kombëtare e Biznesit” (në vijim, “QKB ose Kontrolluesi”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 179, datë 07.11.2023 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- *Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.*

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është institucion në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës e Inovacionit, i krijuar me ligjin nr. 131/2015 “Për qendrën kombëtare të biznesit” dhe funksionon si një qendër e vetme me një ndalesë për ofrimin e shërbimeve që i janë ngarkuar me ligj, të tilla si: regjistrimi dhe licensimi i biznesit, autorizimet dhe lejet, si dhe regjistrimit të pronarëve përfutës, sipas legjisllacioneve respektive.
2. Nga verifikimi në vend rezulton se, Kontrolluesi ka tre sisteme elektronike, të tilla si: “eRegister për regjistrin tregtar”, “Regjistrin e Pronarëve Përfutës” dhe “eRegister

për regjistrin e licensave, lejeve dhe autorizimeve”, të cilët janë të integruar në faqen zyrtare <https://qkb.gov.al>.

Shërbimet funksionale lidhur me regjistrimin, licensimin dhe regjistrimin e pronarëve përfitues, ofrohen vetëm në mënyrë elektronike, nëpërmjet sportelit elektronik në portalin e-albania, sipas parashikimeve të ligjit për regjistrimin e biznesit, ligjin për licensimin e biznesit, ligjin për regjistrimin e pronarëve përfitues, ligjin për nënshkrimin elektronik dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre. Lëshimi i certifikatave dhe i ekstrakteve të regjistrimeve bëhet me vulë elektronike.

“Regjistri Tregtar” është krijuar sipas parashikimeve të nenit 18 të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 *“Për Regjistrimin e Biznesit”*, i ndryshuar (në vijim, *“Ligji nr. 9723”*), si një bazë të dhënash unike, e ndarë në dosje të veçanta elektronike për secilin subjekt që ka detyrimin e regjistrimit dhe mbahet në format elektronik. Popullimi i këtij sistemi kryhet online përmes portalit qeveritar “e-Albania”, duke ngarkuar të gjithë informacion e nevojshëm që kërkohet sipas këtij ligji nga përfaqësuesit e subjekteve tregtare.

Referuar nenit 2 të Ligjit nr. 9723, *“Të dhënat janë: faktet, aktet dhe informacionet që regjistrohen, njoftohen apo depozitohen në regjistër”*. Në nenet 28 – 47 parashikohen të dhënat që janë të detyrueshme për regjistrimin e një subjekti tregtar, si dhe të dhënat e tjera të parashikuara në nenin 44, të cilat jepen në mënyrë vullnetare nga subjekti tregtar.

Të gjitha të dhënat, aplikimet dhe dokumentet shoqëruese, të paraqitura në format shkresor apo elektronik, sipas këtij ligji, do të regjistrohen nga QKB-ja, vetëm në format elektronik në dosjen e subjektit, në regjistrin përkatës.

Sipas nenit 19 të Ligjit nr. 9723, regjistri përmban të dhëna, që i përkasin themelimit, veprimtarisë dhe çregjistrimit të subjekteve, çdo ndryshim në status dhe organizimin e subjektit, të dhëna, që i përkasin atij në lidhje me përfaqësimin, si dhe të dhëna të tjera, të parashikuara në këtë ligj. *[Niveli i aksesit në sistemin dhe bazën e të dhënave të Regjistrit Tregtar *****...]*.

“Regjistri Kombëtar i Licensave, Autorizimeve dhe Lejeve (RKLAL)” është ngritur sipas ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 *“Për Licensat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”* (në vijim, *“Ligji nr. 10081”*). Ky regjistër funksionon si një portal i integruar të dhënash elektronike, që shërben si instrument procedural për publikimin, shpalljen, arkivin elektronik zyrtar, si dhe siguron transparencën në fushën e licensimit, të autorizimit dhe dhënies së lejeve.

Çdo licencë/autorizim/leje e dhënë nga institucionet qendrore apo institucionet e pavarura, hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Regjistrin Kombëtar të Licensave, Autorizimeve dhe Lejeve, përveçse kur hyrja në fuqi e aktit që e miraton atë, lidhet me botimin në Fletoren Zyrtare.

RKLAL organizohet në tri pjesë:

- a) regjistri i nismave ligjore dhe nënligjore në fushën e licensimit/autorizimit/lejeve;
- b) regjistri informativ, sipas kategorive të licensave, autorizimeve dhe lejeve;
- c) regjistri aplikativ i licensave dhe lejeve.

Të dhëna parësore (të dhëna të krijuara sipas Ligjit nr. 10081) të **RKLAL**, konsiderohen:

- a) formularët e aplikimit dhe të dhënat e pasqyruara në formularin e aplikimit;
- b) çdo kërkesë për pajisjen me licensë/autorizim/leje të caktuar apo për bërjen e ndryshimeve në të;
- c) çdo vendim i ndërmjetëm i institucioneve të tjera, të përfshira në procesin e vlerësimit të përmbushjes së kushteve të licensimit/autorizimit/lejeve;
- ç) çdo vendim për miratimin apo refuzimin përfundimtar të një kërkesë;
- d) çdo vendim për urdhërimin e ripërmbushjes së kritereve apo të ndreqjes së shkeljeve të detyrimeve të licensës/autorizimit/lejes apo pezullimin e tyre;
- dh) çdo vendim për revokimin e një license/autorizimi/lejeje;
- e) çdo vendim administrativ apo gjyqësor, të nxjerrë për ankimet ndaj vendimeve të parashikuara në shkronjat “b” deri në “d” të këtij paragrafi;
- e) çdo licensë/autorizim apo leje të dhënë e të vlefshme;
- f) vendimet e gjykatës, për heqjen titullarit të një license/autorizimi apo lejeje të së drejtës, për të ushtruar veprimtarinë e licensuar apo heqjen e së drejtës së përdorimit të të mirës publike;
- g) çdo vendim tjetër për një licensë/autorizim apo leje të caktuar.

Të dhëna dytësore (të dhëna të marra nga regjistra të tjerë kombëtarë) konsiderohen tërësia e dokumenteve provuese dhe shoqëruese, të parashikuara në nenin 3 të Ligjit nr. 10081. Informacioni që regjistrohet dhe publikohet në Regjistrin kombëtar të Licensave, Autorizimeve dhe Lejeve ndahet, si vijon:

- *Regjistri i nismave ligjore dhe nënligjore*, i cili përmban të gjitha projekt-aktet e nismave ligjore dhe nënligjore në fushën e licensimit/autorizimit dhe lejeve, raportin përkatës të vlerësimit të pasojave dhe mendimin këshillimor të QKB;
- *Regjistri informativ*, i cili përmban, për çdo kategori license/autorizimi/lejeje, të paktën këto lloje të dhënash:
 - kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi;
 - kriteret dhe detyrimet e licensimit, të autorizimit apo lejimit, dokumentet shoqëruese që duhen paraqitur dhe formularët e aplikimit;
 - procedurat e aplikimit, të shqyrtimit dhe vendimmarrjes;
 - udhëzimet për bërjen e kërkesave.
- *Regjistri aplikativ*, i cili përmban këto të dhëna:
 - çdo kërkesë për pajisjen me licensë/autorizim, leje të caktuar apo për bërjen e ndryshimeve në të;

- çdo vendim të ndërmjetëm të institucioneve të tjera, të përfshira në procesin e vlerësimit të përmbushjes së kushteve të licensimit/lejimit;
- çdo vendim për miratimin apo refuzimin përfundimtar të një kërkesë;
- çdo vendim për urdhërimin e ripërmbushjes së kritereve, të ndreqjes së shkeljeve të detyrimeve apo pezullimin e licensës/autorizimit, lejes;
- çdo vendim për revokimin e një license/autorizimi/leje;
- çdo vendim administrativ apo gjyqësor, të nxjerrë për ankimet ndaj vendimeve, të parashikuara në shkronjat "b" deri në "d" të kësaj pike;
- çdo licensë/autorizim apo leje të dhënë e të vlefshme;
- vendimet e gjykatës, për heqjen titullarit të një license/autorizimi apo lejeje të së drejtës, për të ushtruar veprimtarinë e licensuar apo heqjen e së drejtës së përdorimit të të mirës publike;
- çdo vendim tjetër për një license/autorizim apo leje të caktuar.

“Regjistri i Pronarëve Përfitues” është një sistem elektronik, në të cilin regjistrohen të dhënat e pronarëve përfitues të subjekteve që kanë detyrimin e raportimit të tyre, dhe mbledh në kohë reale të dhënat e regjistruara në regjistrat respektivë të administruara nga institucionet shtetërore përkatëse, si dhe shërben si arkiv elektronik zyrtar, me qëllim sigurimin e transparencës në fushën e pronarëve përfitues.

Ky regjistër popullohet me të dhëna nga regjistri tregtar, regjistri i organizatave jofitimprurëse, subjektet raportuese, subjektet të cilat i nënshtrohen ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, autoritetet kompetente shtetërore, si: Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Banka e Shqipërisë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, etj.

Bazuar në pikën 10, të VKM nr. 673, në përbërje të AKSHI-t, pranë çdo institucioni dhe organi të administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, krijohen dhe funksionojnë Njësitë e Teknologjisë së Informacionit e të Komunikimit (NJTIK), si strukturë organizativo-teknike për projektimin, zbatimin dhe administrimin e qeverisjes elektronike në institucion, nëpërmjet teknologjisë së informacionit e të komunikimit (TIK). Pranë QKB-së, funksionon struktura NJTIK, e cila administron infrastrukturën ku ngrihen sistemet respektive të Kontrolluesit, së bashku me komponentët e tjerë të teknologjisë së informacionit.

Nga verifikimi në vend i regjistrave elektronikë që administron QKB, sipas ligjit organik, konstatohet se:

- Nuk ka të hartuar planin e politikave të vazhdueshmërisë së biznesit, dokumente këto që do të duhet të përmbanin politikat dhe objektivat e miratuara që sigurojnë vazhdueshmërinë e punës së regjistrave elektronikë që disponon;
- Masat e ndërmarra në drejtim të backup-it janë të pamjaftueshme dhe nuk japin siguri në mbështetjen e planit të vazhdueshmërisë së biznesit (BCP) dhe planit të rikuperimit (DRP), në kundërshtim kjo me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;

- Nuk ka kryer Analizën e Ndikimit në të Dhënat Personale të operacioneve të përpunimit gjatë ushtrimit të veprimtarisë;
- Për shkak të rëndësisë dhe natyrës së që ka, nuk ka hartuar rregullore/politika për përdorimin e infrastrukturës TIK që disponon.

Gjithashtu, Kontrolluesi, edhe pse ju kërkua verbalisht dhe elektronikisht, nuk vuri në dispozicion të grupit të kontrollit, termat e referencës (specifikimet teknike, Tors, etj.) të infrastrukturës TIK, për të tre regjistrat elektronikë që kryejnë përpunim të dhënash. Konstatohet se, masat teknike të sigurisë të parashikuara në projektin teknik, mënyra e ndërveprimit dhe të nivelit të aksesit që ka secili regjistër me palët e treta, nuk janë në përputhje me parashikimet e VKM nr. 945, datë 2.11.2012 *“Për Miratimin e Rregullores “Administrimi i Sistemit të Bazave të të Dhënave Shtetërore”*, i ndryshuar (në vijim, *“VKM nr. 945”*) dhe VKM nr. 710, datë 21.08.2013 *“Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”* (në vijim, *“VKM nr. 710”*), në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, krijimi i procedurave të backup dhe vazhdimësisë së punës për sistemet e informacionit, për sistemet elektronike, duhet të kryhet në përputhje me VKM nr. 945 dhe VKM nr. 710, të cilat kanë për qëllim përcaktimin e procedurave standarde të politikave të administrimit dhe funksionimit të sistemeve elektronike, për rrjedhojë të garantimit të sigurisë të të dhënave personale, në përputhje me nenin 27 të Ligjit.

Dokumentimi i procedurave dhe politikave, si dhe zbatimi i tyre në lidhje me sigurinë e informacionit, është një ndër masat dhe detyrat kryesore që duhet të ndërmerret Kontrolluesi, në lidhje me sigurinë dhe funksionimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit.

Sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi nuk ka marrë masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht në këtë rast, kur përpunimi i të dhënave kryhet nëpërmjet komunikimeve elektronike, në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit, datë 14.09.2018 *“Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”* (në vijim, *“Udhëzimi nr. 47”*).

Gjithashtu, në çdo rast, përgjegjësia për të garantuar sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale qëndron për çdo kontrollues, bashkëkontrollues apo përpunues që ka akses në të dhënat në sistemet elektronike. Një nga masat kryesore për garantimin e sigurisë së të dhënave personale dhe konfidencialitetit të të dhënave është edhe gjurmueshmëria e veprimeve përpunuese dhe verifikimi i vazhdueshëm i tyre, në zbatim të neneve 27, 28 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit.

3. Referuar pikës 2 të nenit 58, të ligjit nr. 9723, parashikohet se QKB-ja detyrohet të kryejë publikimin e të dhënave të regjistruara. Nga verifikimet në vend, rezulton se, vizitorët e faqes zyrtare <https://qkb.gov.al/>, mund të kërkojnë dhe shkarkojnë dokumente/informacione nga të tre regjistrat, nëpërmjet rubrikës “*kërko*”. Konkretisht, në rubrikën “*kërko për subjekt*”, të faqes online zyrtare, publikohen ekstrakte me të dhëna të subjekteve tregtare, të tilla si: “*nipiti*”, “*aksioneri*”, “*emri i subjektit*”, “*emri tregtar*”, “*adresa*” dhe “*numri i identifikimit*”, etj.

Konstatohet se, publikimi i disa kategorive të të dhënave, të përfshira në kontratat me të tretë, informacione lidhur me identifikimin fizik apo identitetin e subjekteve të të dhënave, adresat e individëve të caktuar, si dhe të dhënat e llogarive bankare të subjekteve të treta, kryhen në kundërshtim me parimet dhe kriteret e neneve 5 dhe 6 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, përhapja e të dhënave, si një formë e vecantë përpunimi (sipas përkufizimit në pikën 12, të nenit 3 të Ligjit), duhet të realizohet në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të përpunimit, të parashikuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit.

Në germën “*b*”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit, parashikohet se mbrojtja e të dhënave personale bazohet “*...në grumbullimin për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime*”.

Sipas nenit 6 të Ligjit, të dhënat personale përpunohen vetëm nëse plotësohet një prej kriterëve të përpunimit: “*a) nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin;... ç) për përmbushjen e një detyrimi ligjor të kontrolluesit...;*”, etj.

Në zbatim të detyrimeve që parashikon Ligji, Zyra e Komisionerit vlerëson se, QKB, në cilësinë e Kontrolluesit për të dhënat e grumbulluara gjatë proceseve përpunuese, duhet të marrë masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të publikuar vetëm të dhënat që janë të nevojshme për të realizuar qëllimin e përpunimit, në zbatim të parimeve dhe kriterëve të Ligjit, si dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit specifik.

Marrja e masave të mësipërme nga ana e Kontrolluesit, garanton përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale, në përputhje me nenin 35 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Ky proces përpunimi është i vazhdueshëm dhe përfshin një sasi të konsiderueshme të dhënash personale, e si i tillë kërkon një kujdes të veçantë nga ana e Kontrolluesit gjatë publikimit, pasi të dhënat që ngarkohen në sistem përfshijnë edhe të dhëna sensitive, për të cilat Ligji parashikon dispozita të veçanta për të theksuar rëndësinë e tyre. Gjithashtu, Kontrolluesi duhet të vlerësojë me kujdes kategoritë e të dhënave sensitive që përpunohen, duke pasur gjithnjë parasysh parimin e proporcionalitetit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, mosmarrja e masave nga ana e Kontrolluesit, për garantimin e përpunimit të ligjshëm të të dhënave personale në lidhje me publikimin e të dhënave, mund të çojë në urdhërimin e bllokimit të këtij procesi përpunimi.

4. Kontrolluesi disponon rregullore të brendshme me nr. 5311/1 prot., datë 19.04.2021 dhe rregullore *“Për Mbrojtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale”*, me nr. 5225/4 prot., datë 31.12.2018.

Nga analizimi i rregullores së brendshme dhe rregullores së posaçme, rezulton se Kontrolluesi nuk ka parashikuar afate konkrete, lidhur me kohën e ruajtjes së të dhënave personale, për dokumentacionin që administrojnë në funksion të veprimtarisë që ushtron.

Konstatohet se, Kontrolluesi grumbullon në arkivin fizik të Zyrës së Burimeve Njerëzore të QKB, dokumentacionin për punonjësit aktualë dhe të larguar. Në dosjet e punonjësve gjenden dokumente, të tilla si: vërtetim i gjendjes gjyqësore, dëshmi e aftësisë për punë, etj, në kundërshtim me parimin e mjaftueshmërisë, sipas parashikimit në germën “c”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit.

Për më tepër, të dhënat e ish-punëmarrësve ruhen në arkivën fizike të Kontrolluesit pa përcaktuar një afat konkret për ruajtjen e tyre, në kundërshtim me germën “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, lidhur me të dhënat personale të grumbulluara gjatë ushtrimit të veprimtarisë, Kontrolluesi duhet të parashikojë ruajtjen e të dhënave personale të grumbulluara, në atë formë, që lejon identifikimin për një kohë të caktuar, por jo më tepër sesa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin e grumbullimit. Koha e ruajtjes së të dhënave personale duhet të përcaktohet nga Kontrolluesi, në përputhje me parashikimet ligjore specifike dhe qëllimin e grumbullimit të informacionit.

5. Në kuadër të detyrimeve ligjore që ka Kontrolluesi, është mundur ndërveprimi i regjistrave elektronikë të QKB me regjistra të tjerë elektronikë, me qëllim shkëmbimin e të dhënave. Megjithatë, konstatohet se, Regjistri i Pronarëve Përfitues dhe Regjistri Tregtar është i integruar me platformën qeveritare të ndërveprimit Government Gateway (GG), nëpërmjet të cilit merr të dhëna automatikisht nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile (në vijim, “RKGJC”). Kontrolluesi nuk paraqiti bazë ligjore apo argumenta shtesë në lidhje me kategorinë e të dhënave personale për të cilat ka akses në databazën e RKGJC. Në këtë kuadër, që procesi i përpunimit të të dhënave (në këtë rast, ndërveprimi ndërmjet databazave) të jetë i ligjshëm, sipas parashikimeve në nenet 5 dhe 6 të Ligjit, Kontrolluesi duhet të vlerësojë dhe të përcaktojë kategorinë e të dhënave në bazë të legjislationit të posaçëm, në ndërveprim me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Gjithashtu, Kontrolluesi duhet të respektojë, procedurën e parashikuar në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, ligjin nr. 10 129, datë 11.5.2009 *“Për gjendjen civile”*, i ndryshuar, si dhe aktin

nënligjor të dalë në zbatim të tij, Udhëzimin e përbashkët nr. 463, datë 10.12.2020 *“Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin”*, (në vijim, “Udhëzimi nr. 463”) të Ministrisë të Brendshme dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Në Udhëzimin e përbashkët nr. 463, të Ministrisë të Brendshme dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është parashikuar lista e institucioneve të cilat mund të marrin të dhëna personale nga shërbimi i Gjendjes Civile, për shkak të autorizimit të këtij ndërveprimi nga një dispozitë ligjore konkrete. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së këtij Udhëzimi, rezulton se QKB nuk renditet në listën e autoriteteve që marrin informacion nga RKGJC.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, institucionet, organet, personat juridikë publikë (kontrolluesit publikë), mund të marrin të dhëna personale nga RKGJC, nëse kjo e drejtë njihet me ligj të veçantë. Mënyra, lloji dhe sasia e informacionit që mund të marrin, përcaktohet në Aneksin 1, të Udhëzimit të sipërcituar.

Gjithashtu, në pikën 4, të Udhëzimit nr. 463, përcaktohet se: *“Për marrjen e informacionit në rrugë elektronike, kriteret dhe kushtet përcaktohen në marrëveshjen dypalëshe midis Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe Kontrolluesit përkatës, dhe/ose sipas parashikimeve të tjera të legjislacionit në fuqi”*.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi duhet të marrë masa dhe të ndjekë procedurën e parashikuar në Udhëzimin nr. 463, për përfshirjen e tij në Aneksin 1 të këtij Udhëzimi.

6. Kontrolluesi ka të instaluar një sistem video survejimi CCTV, me anë të të cilit kryen monitorimin e ambienteve fizike gjatë ushtrimit të aktivitetit. Njësia qendrore e mbikëqyrjes të sistemit CCTV, është vendosur në ambientet e Kontrolluesit. Sistemi i survejimit CCTV, është i përbërë nga tetë kamera, me anë të të cilave kryen mbikëqyrjen e ambienteve të jashtme dhe ambienteve të brendshme. Në ambientet e brendshme, konstatohet prania e kamerave pranë sportelit dedikuar pritjes së vizitorëve dhe subjekteve tregtare, në korridore, si dhe zyrave të administratës së Kontrolluesit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi për vendosjen e sistemit të survejimi CCTV në ambientet e tij, duhet të bëjë një vlerësim në raport me parashikimet e neneve 5 dhe 6 të Ligjit. QKB, rast pas rasti, duhet të vlerësojë, vendosjen e kamerave CCTV, si dhe të bëjë seleksionimin e ambienteve, të cilat duhen monitoruar, duke argumentuar në akte të brendshme rregullatore arsyen e vendosjes së tyre, në përputhje me dispozitat e parashikuara në Ligj.

Kontrolluesi ka detyrimin të marrë masa në lidhje me ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale, në respektim të parimeve të mbrojtjes së të dhënave personale dhe kriteret ligjore të përpunimit, ku parashikohet se përpunimi i të dhënave personale

legjitimohet vetëm nëse plotësohet një nga kushtet e sanksionuara në nenin 6 të Ligjit. Mbikëqyrja e ambienteve të posteve të punës të punonjësve, është në kundërshtim me parashikimet e neneve 5 dhe 6 të Ligjit, si dhe Udhëzimit nr. 11, datë 08.09.2011 të Komisionerit “*Mbi përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat*”, i ndryshuar (në vijim, “*Udhëzimi nr. 11*”).

7. Kontrolluesi nuk informon subjektet mbi përpunimin e të dhënave imazhe-video nëpërmjet sistemit të video survejimit (CCTV), në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 3, datë 05.03.2010 të Komisionerit “*Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*”, i ndryshuar (në vijim, “*Udhëzimi nr. 3*”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale, të njihen me të drejtat që gëzojnë si dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërbushja e këtij detyrimi nga ana e Kontrolluesit, mund të sjellë pasoja sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave. Kur mbledh të dhëna personale, Kontrolluesi duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, mënyrën e përpunimit, të drejtën për akses, të drejtën për korrigjim të të dhënave të tij, etj.

8. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese, si dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit rezulton se, Kontrolluesi ka përbushur detyrimin për “*Njoftim*”, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit. Megjithatë, konstatohet se: “*Njoftimi*” ka mangësi në deklaram, sa i përket rubrikave të formularit, si vijon:

- i. Deklarimi në rubrikën 1.2 të formularit të njoftimit: “*Personi i kontaktit ngarkuar nga subjekti*”;
- ii. Deklarimi në rubrikën 3.1 të formularit të njoftimit: “*Kategoritë e të dhënave personale që përpunohen*”.

Konstatimet e mësipërme janë në kundërshtim me parashikimet e neneve 21 dhe 22 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se përbushja e detyrimit për ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 21 të Ligjit është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen Kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i jep Ligji.

9. Kontrolluesi disponon “*Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, megjithatë nga shqyrtimi i përmbytjes së saj konstatohet se,

rregullorja nuk parashikon proceset, procedurat, masat teknike dhe organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 dhe 28 të Ligjit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të Kontrolluesit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i një *“Rregulloreje specifike për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”* në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit, për të mundësuar shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

- 10.** Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Grupi i kontrollit, ka konstatuar mosplotësim të detyrimeve në lidhje ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e Sistemit të Menaxhimit së Sigurisë së Informacionit (SMSI) lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, të parashikuara në Udhëzimin nr. 47 të Komisionerit, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veçantë të veprimtarisë që Kontrolluesi ushtron.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, trajnimet në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale duhet të jenë të vazhdueshme dhe të përshtatura, sipas nevojave dhe proceseve të punës të Kontrolluesit, me qëllim ndërgjegjësimin e punonjësve, të cilët për shkak të proceseve të punës, janë të ngarkuar për përpunimin e të dhënave personale.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Kontrolluesi, është i detyruar të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë SMSI, në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 47.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit me rrugë postare, nëpërmjet shkresës nr. 64/2 prot., datë 11.01.2024.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesit e Kontrolluesit janë paraqitur në seancën dëgjimore të datës 23.01.2024, të organizuar nga Zyra e Komisionerit dhe kanë deklaruar angazhimin për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara gjatë hetimit administrativ të ushtruar, si dhe kanë paraqitur argumentet, si vijon:

- Në lidhje me konstatimet e grupit të kontrollit se : “...masat e ndërmarra në drejtim të backup-it janë të pamjaftueshme dhe nuk japin siguri në mbështetjen e planit të vazhdueshmërisë së biznesit (BCP) ...”, Kontrollues argumenton se, “...ju bëjmë me dije se për periudhën 2018-2023 AKSHI ka disponuar tre versione të dokumentit Politika e Vazhdimësisë së Biznesit, konkretisht versione të vitit 2018, 2021 dhe Qershor 2023 në përputhje me kërkesat e certifikimit me standardin ISO 27001, certifikim të cilin AKSHI e disponon. Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Qeverisjen Elektronike, në zbatim të germës “c” të nenit 9 të Ligjit nr. 43/2023 “Për Qeverisjen Elektronike”, është miratuar Udhëzimi nr. 1 datë 31.07.2023 “Për zbatimin e dokumentit të përditësuar të politikave të vazhdimësisë së punës dhe planit për ruajtjen e informacionit”, nga Drejtori i përgjithshëm i AKSHI-t. Ky udhëzim është i publikuar dhe në faqen zyrtare të AKSHI-t. Në vijim të përcaktimeve që bëhen në këtë udhëzim por edhe përcaktimeve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, ju bëjmë me dije se, Politikat e Vazhdimësisë së Punës dhe të Rikuperimit për sistemin e informacionit të QKB janë në proces hartimi/përditësimi dhe do të dokumentohen”.

Sa i përket këtyre argumenteve, Zyra e Komisionerit vlerëson se ato nuk qëndrojnë, pasi është QKB, në cilësinë e Kontrolluesit, i cili vetëm apo së bashku me të tjerë, përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore të fushës. QKB është përgjegjëse për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në Ligj, pavarësisht mënyrës së përpunimit të të dhënave dhe mekanizmave të përdorur, përfshirë dhe përmbushjen e detyrimeve të nenit 27 të Ligjit.

Gjithashtu, sa i përket administrimit të sistemeve elektronike nga NJTIK (e AKSHI-t), Zyra e Komisionerit vlerëson se Kontrolluesi (QKB), duhet të jetë në gjendje të demonstrojë kontrollin dhe të garantojë përdorimin e ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave, në mënyrë që përpunimi i tyre të kryhet vetëm në përputhje me udhëzimet e tij.

Bazuar në ligjin nr. 43/2023 “Për Qeverisjen Elektronike” dhe VKM nr. 673, AKSHI, në cilësinë e institucionit përgjegjës për ofrimin e sigurisë për institucionet nën varësinë e Këshillit të Ministrave, mbart detyrimin për të garantuar sigurinë dhe pacenueshmërinë vetëm të sistemeve dhe të infrastrukturave të përdorura nga institucionet shtetërore, si në rastin e QKB. Dispozitat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, në lidhje me aspektet e sigurisë së të dhënave, nuk përjashtojnë nga përgjegjësia ligjore Kontrolluesin, i cili ka detyrimin të mbajë përgjegjësi dhe të demonstrojnë përgjegjshmëri për realizimin e proceseve përpunuese, në përputhje me dispozitat e Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se angazhimi i përpunuesve të tjerë (të përcaktuar në akte nënligjore), nuk çliron Kontrolluesin nga përgjegjësitë e tij për të mbikëqyrur dhe monitoruar aspektet e sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave, që vetë Kontrolluesi është i autorizuar me ligj, të përpunojë dhe administrojë.

- Në lidhje me pretendimin e QKB për konstatimet e grupit të kontrollit se: *“..nuk ka kryer Analizën e Ndikimit në të Dhënat Personale të operacioneve të përpunimit gjatë ushtrimit të veprimtarisë..”*, Kontrolluesi argumenton se, *“...QKB në respektim të dispozitave të ligjit ‘Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale’, ka ndër marrë masat për mospublikimin për palët e treta të dokumentacionit: Formulari i aplikimit, akti i cili prodhohet nga vetë institucioni dhe në përmbajtje të tij ka të dhëna personale; Dokumentet e identifikimit që paraqiten nga vetë subjektet, si dokumentacion mbështetës, si dhe QKB, bën publike aktet e detyrueshme për regjistrim në bazë të dispozitave të Ligjit 9723, datë 03.05.2007 ‘Për Regjistrimin e Biznesit’, i ndryshuar, vlen të theksohet se aktet, të cilat bëhen pjesë e Regjistrimit Tregtar, janë akte të hartuara nga vetë subjektet tregtare dhe QKB, nuk ka asnjë tagër ligjor të ndërhyjë në dokumentet, për të ndryshuar/fshirë, apo ndryshuar, të dhënat personale që mban vetë dokumenti....”*.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, pretendimet e Kontrolluesit nuk qëndrojnë. Nga kërkimi në ekstraktet historike të subjekteve tregtare, të cilët janë lehtësisht të aksesueshëm në faqen zyrtare të Kontrolluesit, konstatohet qartësisht se në brendësi të tyre, gjenden të publikuara dokumentacione që përmbajnë të dhëna personale dhe sensitive të subjekteve tregtare. Kategoritë e të dhënave të konstatuara përfshijnë identifikimin fizik apo identitetin e subjekteve të të dhënave, adresat e individëve të caktuar, si dhe të dhënat e llogarive bankare të subjekteve të treta.

Argumenti i përdorur nga Kontrolluesi, sipas të cilit, të dhënat vendosen në dispozicion nga vetë subjektet tregtare, nuk qëndron. Kontrolluesi ende nuk e ka të qartë që ky proces është i përbërë nga disa faza. Në fazën e parë, është mbledhja e dokumentacionit, nga ana e Kontrolluesit, me qëllim regjistrimin e subjekteve tregtare. Kjo fazë është tërësisht legjitime dhe nuk gjen kundërshtim nga ana e Zyrës së Komisionerit, pasi Kontrolluesi po ushtron të drejtat e parashikuara në legjislacionin specifik, sa i takon mbledhjes së të dhënave të domosdoshme për regjistrimin e subjekteve tregtare. Megjithatë, pas këtij procesi vijohet me fazën e dytë ose fazën e publikimit. Në këtë fazë, nuk kuptohet qartë nga ana e Kontrolluesit, kategorizimi dhe marrja e masave konkrete të publikimit vetëm të të dhënave që janë të nevojshme për realizimin e qëllimit të përpunimit, si dhe detyrimet tjera që i ngarkohen me ligj lidhur me publikimin, për shkak të statusit të tij si Kontrollues. QKB duhet të tregojë një kujdes të veçantë që publikimi i të dhënave të jetë në legjitimitet të plotë, sipas kërkesave të legjislacionit specifik, si dhe në harmonizim me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

- Në lidhje me konstatimet e grupit të kontrollit se: *“..referuar gjetjes se ‘Termet e referencës (specifikimet teknike, Tors, etj.) të infrastrukturës TIK, për të tre regjistrat*

elektronike për të cilët kryejnë përpunimin e të dhënave. Sa më sipër, Kontrolluesi nuk i vuri në dispozicion”, Kontrolluesi argumenton se, “...QKB është institucion përfitues i këtij shërbimi. Për sa më sipër mund t’i drejtoheni AKSHI-t për këto të dhëna teknike. Në lidhje me konstatimin e grupit të kontrollit sjellim në vëmendjen tuaj se, AKSHI në zbatim të Ligjit nr. 43/2023 “Për Qeverisjen Elektronike” AKSHI ka hartuar, Rregulloren Nr. 2 datë 06.11.2023 “Për Sigurinë e Informacionit” e cila ka si qëllim vendosjen e qasjes dhe masave që do të zbatohen nga institucionet nën varësinë e Këshillit të Ministrave për të garantuar mbrojtjen e aseteve dhe të informacionit dhe për të minimizuar rreziqet që lidhen me dëmtimin, tjetërsimin dhe keqpërdorimin e tyre..”.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, pretendimet e Kontrolluesit nuk qëndrojnë. Bazuar në nenin 27 të Ligjit, QKB, në cilësinë e Kontrolluesit, duhet të garantojë marrjen e masave për sigurinë e të dhënave personale, konkretisht, duhet të marrë masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi. Kontrolluesi, nuk mund të justifikojë anomalitë dhe cenimet eventuale në sigurinë e të dhënave, me faktin se për këtë qëllim është përgjegjës AKSHI.

- Në lidhje me konstatimet e grupit të kontrollit se, “...publikimi i disa kategorive të të dhënave, të përfshira në kontratat me të tretë, informacione lidhur me identifikimin fizik apo identitetin e subjekteve të të dhënave, adresat e individëve të caktuar, si dhe të dhënat e llogarive bankare të subjekteve të treta, kryhen në kundërshtim me parimet dhe kriteret e neneve 5 dhe 6 të ligjit...”, Kontrolluesi argumenton se, “...transparenca, është nga parimet thelbësore dhe funksioni i QKB-së, për publikimin e të dhënave të regjistrit të mbajtur, si dhe sigurimi i aksesit të lirë të publikut në to është një funksion shumë i rëndësishëm. QKB, sot siguron aksesin e lirë të publikut në të dhënat e regjistrit të mbajtur, përveç të dhënave që mbrohen nga Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale.

Një nga funksionet kryesore dhe të rëndësishme të QKB-së, është publikimi i të dhënave. QKB publikon çdo të dhënë të regjistruar në regjister, në Buletinin e Njoftimeve Zyrtarë të Regjistrimit, i cili mbahet nga QKB në format elektronik dhe botohet në faqen e saj zyrtare të internetit www.qkb.gov.al...

QKB, bën publike aktet e detyrueshme për regjistrim në bazë të dispozitave të Ligjit 9723, datë 03.05.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar, vlen të theksohet se aktet, të cilat bëhen pjesë e Regjistrit Tregtar, janë akte të hartuara nga vetë subjektet tregtare dhe QKB, nuk ka asnjë tagër ligjor të ndërhyjë në dokumentet, për të ndryshuar/fshirë, apo ndryshuar, të dhënat personale që përmban vetë dokumenti. QKB bën publike aktet e detyrueshme për regjistrim në bazë të dispozitave të Ligjit 9723, datë 03.05.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit”.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, pretendimet e Kontrolluesit nuk qëndrojnë. Përpunimi i të dhënave personale dhe përhapja e të dhënave si një formë e veçante përpunimi, duhet të realizohet në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të përpunimit, të parashikuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit.

Referuar nenit 5 të Ligjit, parashikohet se mbrojtja e të dhënave personale bazohet “...në grumbullimin për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime” (gërma “b” e pikës 1, të nenit në fjalë).

QKB, në cilësinë e kontrolluesit, për të dhënat e grumbulluara gjatë proceseve përpunuese për qëllime specifike të përcaktuara qartë dhe legjitime në përputhje me këto qëllime, nuk duhet të publikojë për palë të treta, të dhëna të cilat nuk parashikohen nga ligji specifik. Kontrolluesi, duhet të gjejë mënyra dhe të marrë masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të publikuar vetëm të dhënat që janë të nevojshme për të realizuar qëllimin e përpunimit, në zbatim të parimeve dhe kriterëve të Ligjit, si dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit specifik.

- Në lidhje me konstatimet e grupit të kontrollit se, “... *Kontrolluesi nuk ka parashikuar afate konkrete lidhur me kohën e ruajtjes së të dhënave personale, për dokumentacionin që administrojnë në funksion të veprimtarisë që ushtron*”, Kontrolluesi argumenton se , “...në zbatim të Ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, dhe të Vendimit Nr. 4, datë 19.06.2017 “Për miratimin e “Rregullores së njehësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë” me Urdhërin nr. 02, datë 05.01.2023 “Për ngritjen e Komisionit të Ekspertizës” ka ngritur Komisionin e Ekspertizës i cili ka hartuar listën e dokumenteve me rëndësi historike kombëtare dhe listën e dokumenteve me afat ruajtje të përkohshme duke përcaktuar dhe afatet e ruajtjes së këtyre dokumenteve sipas procesverbalit nr. 274 prot., datë 09.01.2023. Në këtë procesverbal parashikohen ndër të tjera dhe afatet e ruajtjes së dokumenteve që përmbajnë të dhëna personale...”.

Lidhur me këtë pretendim të Kontrolluesit, Zyra e Komisionerit vlerëson se nuk qëndron. Një nga aspektet e kontrollit të ushtruar pranë Kontrolluesit, lidhet me administrimin dhe mbajtjen e dokumentacionit të punonjësve. Grupi i kontrollit ka analizuar përmbajtjen e dokumentacionit të zgjedhur rastësisht për punonjësit aktualë dhe për stafin e larguar, duke konstatuar se në dosjet e personelit gjenden dokumente, të tilla si: *vërtetim i gjendjes gjyqësore, dëshmi e aftësisë për punë, etj.*, në kundërshtim me parashikimet në gërmen “c”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, lidhur me të dhënat personale të grumbulluara gjatë ushtrimit të veprimtarisë, Kontrolluesi duhet të parashikojë ruajtjen e të dhënave personale të grumbulluara, në atë formë, që lejon identifikimin për një kohë të caktuar, por jo në tejkallim të qëllimit të grumbullimit.

Kontrolluesi, rast pas rasti, duhet të bëjë një vlerësim, për të gjitha proceset e përpunimit, në mbështetje të ligjeve apo akteve nënligjore që rregullojnë fushën e veprimtarisë së tij, si dhe pas analizimit të secilit proces përpunimi, duhet të marrë masa për përcaktimin dhe rregullimin e afateve kohore për ruajtjen e të dhënave për

secilën kategori të dhënash. Koha e ruajtjes së të dhënave duhet të përcaktohet nga Kontrolluesi, në përputhje me parashikimet ligjore specifike dhe qëllimin e përpunimit.

- Në lidhje me konstatimet e grupit të kontrollit se, “ ..kontrolluesi nuk paraqiti bazë ligjore apo prova të tjera, në lidhje me legjitimitimin e këtij ndërveprimi të databazave, për të garantuar këtë proces përpunimi, në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të përpunimit të të dhënave, të parashikuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit... ”, Kontrolluesi argumenton se, “...ndërveprimi i bazave të të dhënave me qëllim ofrimit e shërbimeve publike në mënyrë elektronike për qytetarët dhe bizneset realizohet në përputhje me pikën 3, germa “a” të nenit 14 të Ligjit nr. 43/2023 “Për Qeverisjen Elektronike” ku citohet se, çdo sistem elektronik (bazë të dhënash shtetërore) përdor shërbimin e dërgimit të të dhënave parësore (të cilat janë informacione specifike, të mbledhura në përputhje me aktin e krijimit të bazës së të dhënave) nëpërmjet platformës qeveritare të ndërveprimi, duke pranuar transmetimin e këtyre të dhënave nga administratori i kësaj platforme...”.

Lidhur me pretendimin e ngritur nga Kontrolluesi për ndërveprimin e bazave të të dhënave, Zyra e Komisionerit vlerëson se ky pretendim nuk qëndron. Ashtu sikurse jemi shprehur dhe më lart, Kontrolluesi duhet të rishikojë kuadrin ligjor, në mënyrë që të legjitimojë dhe parashikojë në të, ndërveprimin me databaza të tjera (RKGJC, etj.), përveç atyre të parashikuara në legjislacionin aktual.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në rastet kur një sistem kryen ndërveprim me sisteme elektronike apo platforma teknologjike të tjera, që të garantohet përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, ky proces duhet të plotësojë njërin nga kriteret ligjore të përpunimit, me qëllim legjitimitimin e këtij ndërveprimi.

- Në lidhje me konstatimet e grupit të kontrollit se: “..sistemi i survejimit CCTV, është i përbërë nga tetë kamera, me anë të të cilave kryen mbikëqyrjen e ambienteve të brendshme të zyrave, në kundërshtim me parashikimet e neneve 5 dhe 6 të Ligjit... ”, Kontrolluesi argumenton se, “.. QKB ka të instaluar sistemin e kamerave, por nuk kryen mbikëqyrjen e ambienteve të brendshme të zyrave, sepse asnjë sistem kamere nuk është i instaluar në ambientet e brendshme të zyrave, por në ambientet e korridoreve, hollit, shkallëve, dhe ambientet e përbashkëta, dhe ka të vendosur në këto ambiente shenja treguese që informojnë se ambienti kontrollohet nga kamera. Shtojmë më tej se, QKB ka të miratuar dhe Urdhrin nr. 41, datë 08.11.2018 “Për një ndryshim në urdhrin nr. 213, datë 10.10.2014” Për kamerat në QKB duke përcaktuar vendin ku janë të vendosura kamera dhe personat të cilët kanë akses në këto kamera”.

Lidhur me pretendimin e ngritur nga Kontrolluesi, Zyra e komisionerit vlerëson se nuk qëndron. Referuar provave të administruara gjatë hetimit administrativ, është konstatuar prania e kamerave të sistemit video/audio-survejmimit (CCTV), pranë sportelit dedikuar pritjes së vizitorëve dhe subjekteve tregtare, në korridore, si dhe zyrave të administratës së Kontrolluesit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi për vendosjen e sistemit të survejimi CCTV në ambientet e tij, duhet të bëjë një vlerësim në raport me parashikimet e neneve 5 dhe 6 të Ligjit. QKB, rast pas rasti, duhet të vlerësojë, vendosjen e kamerave CCTV, si dhe të bëjë seleksionimin e ambienteve, të cilat duhen monitoruar, duke argumentuar në akte të brendshme rregullatore arsyen e vendosjes së tyre, në përputhje me dispozitat e parashikuara në Ligj.

Një nga mjetet e rëndësishme të përpunimit të të dhënave personale është edhe CCTV. Të dhënat e ruajtura në këto sisteme si “imazhe” dhe “video”, janë të dhëna personale, dhe përpunimi i tyre duhet të jetë në përputhje me parashikimet e Ligjit, si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërmbyshja e këtij detyrimi nga ana e Kontrolluesit mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit, gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, si dhe angazhimin e tij për të rikuperuar shkeljet e konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe shmang mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 5, 6, 18, 21, 22, 27, 28, 29, 30, 31 (pika 1, germa “a/1”), si dhe 32 të Ligjit, Udhëzimit nr. 3, Udhëzimit nr. 11 dhe Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi, të ketë në vëmendje përpunimin e të dhënave personale, në përputhje me dispozitat e parashikuara në Kreun II të Ligjit;
2. Kontrolluesi, në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të përpunimit, të sanksionuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit, të marrë masa për kufizimin e publikimit të të dhënave të ruajtura/mbledhura në tejkallim të qëllimit të përpunimit, për të cilat ato janë mbledhur;
3. Kontrolluesi duhet të marrë masa dhe të ndjekë procedurën e parashikuar në Udhëzimin nr. 463, për përfshirjen e tij, në Aneksin 1 të këtij Udhëzimi;
4. Kontrolluesi, duhet të vlerësojë ambientet e nevojshme, për të cilat duhet të kryejë mbikëqyrje përmes sistemit të video survejimit CCTV, në përputhje me dispozitat e neneve 5 dhe 6 të Ligjit;

5. Kontrolluesi, të marrë masa për zbatimin e detyrimeve, në lidhje me informimin e plotë të subjekteve të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 18 të Ligjit;
6. Kontrolluesi, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit, të ketë në vëmendje përditësimin e “Njoftimit”, në lidhje me ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave personale, të cilat përpunon;
7. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të përfshijë në “Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, për çdo kategori të dhënash dhe për çdo proces përpunimi, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj.;
8. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me trajnimin e punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale dhe krijimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale.
9. Në zbatim të pikës 1, të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet, sipas këtij akti brenda afateve, si vijon:
 - (i) vazhdimisht, detyrimet e përcaktuara në pikat 1, 5 dhe 6 më sipër;
 - (ii) brenda këtij viti kalendarik, detyrimet e treguara në pikat 2 dhe 3 më sipër;
 - (iii) brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikat 4 dhe 7 më sipër;
 - (iv) brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikën 8 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;

10. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra;
11. Në rast mospërmbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri vepron sipas pikës 2, të nenit 30 dhe nenit 39 të ligjit, të cilët parashikojnë se në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot, më 19.02.2024.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi